



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-112/02-4621
Datë 26.03.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 95 paragrafi 2, nenin 96 paragrafi 3 dhe nenin 103 paragrafi 2 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 8 të Ligjit të Punës numër 03/L-212 si dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) numër 05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimi për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, me datë 26.03.2024 merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni i Pranimi për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitat *teknike dhe mbështetëse në Arsim*, sipas konkursit me numër 01-111/01-4621 të datës 26.03.2024.
2. Komisionin e Pranimi nga pika 1 e këtij vendimi e përbëjnë:
 - 2.1. Mergim Delija – Kryesues
 - 2.2. Erblina Batusha – Anëtare
 - 2.3. Zymber Berisha – Anëtarë
3. Komisioni i Pranimi, ka për detyrë dhe përgjegjësi që të bëjë vlerësimin e kandidatëve që i nënshtrohen procedurave të vlerësimit nëpërmjet jetëshkrimit dhe intervistës me gojë, për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. Komisioni pas përfundimit të procedurës së rekrutimit shpërbëhet menjëherë.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 95 paragrafi 2, nenin 96 paragrafi 3 dhe nenin 103 paragrafi 2 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 8 të Ligjit të Punës numër 03/L-212 si dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) numër 05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimi për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, me qëllim të respektimit të procedurave ligjore të përcaktuara me ligjet në fuqi lidhur me rekrutimin e kandidatëve që kanë aplikuar në pozitat *teknike dhe mbështetëse në Arsim*, në konkursin me numër 01-111/01-4621 të datës 26.03.2024, u caktua komisioni që të bëjë vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.

Bazuar në atë që u tha me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi iu dorëzohet:

- Komisionit të Pranimi
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit


Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës